



PROCESVERBALI

Nga mbledhja e katërt e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Graçanicës

E mbajtur më datën 25.10.2024 në sallën e Kuvendit të Komunës së Graçanicës dhe filloi me punë në orën 11:00.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Millan Dimitrijeviq, hapi mbledhjen duke i përshëndetur të gjithë të pranishmit dhe shtoi se në mbledhje nga 19 asamblistë marrin pjesë 18 asamblistë dhe se ka kuorum, ndërsa mungon asamblisti Millosh Dimiq. Në mbledhje morën pjesë: përfaqësuesit e OSBE-së, përfaqësuesi i UNMIK-ut, drejtori i Drejtorisë së Kadastrës, drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Integrimeve, mediat, Shërbimi për Përkthim dhe Shërbimi për Çështjet e Kuvendit.

Kryesuesi i njoftoi asamblistët se para mbajtjes së mbledhjes së sotme është mbajtur mbledhja e jashtëzakonshme e Komitetit për Politikë dhe Financa si dhe se komiteti e dha mendimin pozitiv për rendin e ditës të caktuar për mbledhjen e sotme të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit tha se duke u bazuar në nenin 44 të Ligjit për vetëqeversijen lokale (nr.03/L-040) është caktuar rendi i mëposhtëm i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tretë e jashtëzakonshme, e mbajtur më datën 26.09.2024.
2. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë së Kosovës për bartjen e pjesëve të parcelës së zonës kadastrale të Komunës së Graçanicës Organizatës “Jetimat e Ballkanit”, me propozim të kryetares së Komunës së Graçanicës, Liljana Shubariq.
3. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tretë e jashtëzakonshme, e mbajtur më datën 26.09.2024.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 18 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e parë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë së Kosovës për bartjen e pjesëve të parcelës së zonës kadastrale të Komunës së Graçanicës Organizatës “Jetimat e Ballkanit”, me propozim të kryetares së Komunës së Graçanicës, Liljana Shubariq.

Drejtori i Drejtorisë së Kadastrës, Nikolla Marinkoviq, tha se sipas autorizimit të kryetares së Komunës së Graçanicë, Ljiljana Shubariq, do ta shjegojë këtë pikë të rendit të ditës. Qeveria e Kosovës ka marr Vendim nr.05/218 të datës 28.08.2024 me të cilin i ka shpallur me interes publik pesë parcela kadastrale, tri prej të cilave janë në pronësi të Komunës së Graçanicës, ndërsa dy të tjerat janë të regjistruara në Qeverinë e Kosovës. Sa i përket parcelave komunale, ato janë parcelat kadastrale 150, 155 dhe 17/8. Për orientim më të lehtë, të gjitha parcelat kadastrale janë të vendosura në vendbanimin Padallishtë. Parcelat i janë ndarë për 99 vjet Shoqatës Bamirëse “Jetimat e Ballkanit” për ndërtimin e Qendrës rezidenciale të Kosovës për autizëm, sindromë daun dhe aftësi të kufizuar për fëmijë me një sipërfaqe totale pak më shumë se 13 hektarë. Edhe pse Vendimi është marrë më 28.08.2024, i njëjtë i është dorëzuar Kabinetit të kryetares së komunës dhe Drejtorisë së Kadastrës më 29-30 shtator.

Kryesuesi shpjegoi se Qeveria e Kosovës në Vendim është orientuar kryesisht në Ligjin për Pronën Publike, ndërsa Ligji për Vetëqeverisjen Lokale është përgjegjës për komunën dhe këshitu janë anashkaluar të gjitha instancat dhe është marrë vendim i njëanshëm. Ai i njoftoi asamblistët se për këtë çështje ishin të interesuar edhe përfaqësuesit e Kombeve të Bashkuara të cilët kërkuan nga ai përgjigje nëse Qeveria e Kosovës i kishte dërguar ndonjë shkresë Kuvendit të Komunës së Graçanicë para se të merrte vendimin, gjë që unë e mohova.

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para partisë “SRPSKA”, tha: “Asamblistët e KK të Graçanicës shumë herë deri më tani me punën dhe veprat e tyre e kanë treguar humanizmin e tyre dhe mirëkuptimin e madh për t'i mbrojtur këta fëmijë. Megjithatë ky vendim i Qeverisë së Kosovës nuk shkon në këtë drejtim. Territori që Qeveria e Kosovës dëshiron të na e marr është skllavërim i dukshëm i serbëve në territorin e Komunës së Graçanicës nën maskën se është çështje e interesit publik. Kosova është mjaft e madhe për të ndërtuar një shtëpi për këta fëmijë në një vend më të mirë. Djerrina, e cila është ndotësi më i madh në territorin e Komunës së Graçanicës, do të jetë fqinji i parë i kësaj Qendre. “A është normale ndërtimi i një shtëpie për fëmijë dhe pleq që tashmë janë të sëmurë në burimin e Djerrinës?”, pyeti dhe kërkoi që të respektohet e drejta e secilit për jetë dhe sugjeroi që vendimi i Qeverisë të refuzohet dhe komuna të bëjë padi.

Asamblistja Sonja Odalloviq, para partisë “SRPSKA”, tha: “Kjo qendër nuk e ka vendin në territorin e Komunës së Graçanicës, sepse qytetarët e Komunës së Graçanicës me dekada janë të ekspozuar ndaj ekocidit të rëndë të shkaktuar nga mbetjet e minierës. Personat me nevoja të veçanta janë shumë të ndjeshëm, me shëndet të dëmtuar dhe janë më të ndjeshëm se popullata e shëndoshë dhe nga ky këndvështrim do të ishte fatkeqësi të ndërtohet një qendër e këtillë. Ju rikujtoj se vitet e fundit është rritur numri i banorëve të Komunës së Graçanicës që vuajnë nga kanceri i rrugëve të fryshtës, ndërsa në vitet e fundit ka gjithnjë e më shumë fëmijë. Unë e kuptoj që Qeveria në Prishtinë nuk e përfshin kujdesin për shëndetin e serbëve dhe joshqiptarëve

të tjerë në politikën e saj dhe se, në përputhje me rrethanat, ata e shtynë katastrofën mjedisore në Graçanicë në një kënd, por nuk mund ta kuptoj se ata me vetëdije, me vendimet e tyre politike, e lëshojnë grupin më të ndjeshëm të njerëzve drejt kësaj fatkeqësie ekologjike”, e cila është edhe kryetare e Komitetit Komunal të Personave me Nevoja të Veçanta. Asamblistja Odalloviq i bëri thirrje Qeverisë së Kosovës, ambasadave dhe faktorëve të tjerë ndërkombetarë në Kosovë që ta anulojnë këtë vendim, që sa më shpejt të bëhet një analizë dhe studim serioz i zgjidhjes së problemit të djerrinës dhe kërkoi nga Komuna e Graçanicës që të merret më seriozisht me këtë problem.

Asamblisti Ljubisha Karaxhiq, para partisë “SRPSKA”, tha: “Nëse vendimi i Qeverisë së Kosovës udhëhiqet nga interesi publik, atëherë është dashur të merret parasysh interesi publik i popullatës lokale. Kemi kaluar kaq vite në diskutime me Ministrinë e Mbrojtjes së Mjedisit për të gjetur një zgjidhje për çështjen e Djerrinës, por gjithmonë pa sukses me pretekstin se toka është pronë e Trepçës dhe se çështjet pronësore nuk janë zgjidhur. Mbi të gjitha është befasues fakti që askush nga Komuna e Graçanicës nuk është konsultuar para se të merret ky vendim. Unë jam kundër këtij vendimi të Qeverisë së Kosovës, sepse nuk është respektuar procedura që të konsultohet Kuvendi i Komunës së Graçanicës dhe vetë komuna”.

Kryesuesi i Kuvendit tha: ”Komuna e Graçanicës, si njësi e vetëqeverisjes lokale, në përputhje me nenin 14 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, ka të drejtë të posedojë dhe menaxhojë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme. Kompetencat e vetëqeverisjes lokale para së gjithash janë të përcaktuara dhe të dhëna me Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nuk mund të derogohen apo të merren me ligje të tjera. Me marrjen e këtij vendimi drejtpërdrejt shkelet ky ligj. Ligji për Vetëqeverisjen Lokale bën pjesë në kategorinë kushtetuese me interes jetik i cili nuk mund të ndryshohet. Në këtë mënyrë një seri e tërë nga ana juridike është anashkaluar si dhe çështja e transparencës sepse vendimi është marr pa asnjë diskutim publik. Askush nga ne nuk thotë “nuk e duam qendrën”. Ne vetëm themi se lokacioni i ndërtimit të asaj qendre është i papërshtatshëm dhe kërkojmë që të rishqyrtohet”.

Asamblisti Millosh Todoroviq, para partisë “SRPSKA”, propozoi që për vendimin e njëanshëm të Qeverisë së Kosovës të ankohen tek të gjitha institucionet ndërkombe tarë që janë ende kompetente në territorin e Kosovës dhe përveç padisë sugjeroi “që të përfshihet çdo lloj proteste demokratike me të cilën do të tregojmë se jemi kundër këtij vendimi dhe në këtë mënyrë ta inkurajojmë Qeverinë që edhe një herë ta rishqyrtojë vendimin”.

Asamblistja Sonja Odalloviq, para partisë “SRPSKA”, tha: “Jam dakord që të iniciohet procesi gjyqësor dhe të ngrihet kallëzim penal, sepse është shkelur neni 52 i Kushtetutës së Kosovës që garanton të drejtën për mjedisit të sigurtë dhe të shëndetshëm dhe neni 25 që garanton të drejtën për jetë”.

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para partisë “SRPSKA”, tha: ”E gjithë kjo zonë dikur ka qenë magazina ushtarake dhe në vitin 1999 është bombarduar me bomba me uranium të varfëruar, që do të thotë se është e ndotur shtesë. Ndërtimi i Qendrës përfëmijët e sëmurë në një vend të tillë mund të lejohet vetëm nga mendjet e sëmura, gjë që tregon se e gjithë kjo është vetëm një maskë”.

Asamblisti Dejan Jevtiq, para partisë “SRPSKA”, tha se i mbështet kolegët e tij asamblistë dhe gjithçka që është cekur. Ai e pyeti kryesuesin se çfarë mund të bëjë Kuvendi lidhur me këtë vendim.

Kryesuesi i Kuvendit u përgjigj se: “Se do t'i propozojë Kuvendit të komunës që të nxjerr një konkluzion, me të cilin do të kërkojmë nga kryetarja e komunës dhe autoritetet komunale që ta iniciojnë procesin dhe të kërkojnë nga Qeveria e Kosovës dhe institucionet ndërkombëtare që kjo të ndalet, sepse ky është një lloj arbitrariteti. Askush nuk ka asgjë kundër organizatës “Jetimat e Ballkanit”, edhe pse ne nuk dimë asgjë për të. Ai dha shembullin se Grmija në Prishtinë, një zonë e rrethuar me pyll, në drejtim të maleve të Sharrit afër Shtimes ose afër lisenit ku ka një park me arinj, vende që janë të pastra dhe natyralisht të pandotura, është dashur të zgjidhet për atë qendër, dhe jo një vend për të cilin shpesh marrim njoftime nga KFOR-i se kur do të deminohet zona. Aty ka shenja që paralajmërojnë rrezik nga minat. Zona nuk është e çminuar. Kjo zonë është goditur ga bomba thërrmuese, raketa dhe bomba ajrore lasike, që do të thotë se askush nuk e di se çfarë ka dhe sa e sigurtë është”.

Asamblisti Nebojsha Markoviq, para partisë “SRPSKA”, tha se nuk është kundër ndërtimit të kësaj qendre, por në një vend tjetër, për arsyen që e kanë thënë deri tanë kolegët e tij asamblistë. Është jo korrekte nga Qeveria e Kosovës, nëse janë të interesuar për parcelat komunale, se nuk kanë mbajtur dëgjime publike si dhe se ajo shoqatë është dashur që fillimisht t'i drejtohet Komunës së Graçanicës. Në pikat 7 dhe 8 të Vendimit të Qeverisë së Kosovës, si dhe ata që dyshojnë në këtë projekt, ”Në pikën shtatë thuhet se në rast të mos shfrytëzimit të ngastrave për destinimin e caktuar në këtë vendim, Shoqatës Bamirëse i merret e drejta e shfrytëzimit, dhe pika tetë thotë po, nëse pas ndërtimit të Kompleksit të qendrës Shoqata Bamirëse nuk e shfrytëzon Kompleksin ai i kthehet në shfrytëzim Qeverisë së Republikës së Kosovës. Kjo do të thotë që nesër Qeveria e Kosovës do ta marr këtë në shfrytëzim për 99 vjet dhe se Qeveria e Kosovës mund të bëjë diçka tjetër me të ose t'ia japë dikujt tjetër, e kështu me radhë, ku nuk do të pyetemi më. Ka shumë pyetje të paqarta. ”Kush do ta financojë shoqatën dhe kush do ta financojë ndërtimin? Dua të them se bëhet fjalë për rreth 13 hektarë - është një sipërfaqe shumë e madhe ku Qeveria e Kosovës mund të bëjë gjithçka nesër, përndryshe nuk jam kundër ndërtimit të asaj qendre, por ka zona dhe territorë në vende të tjera. Pse pikërisht në Graçanicë?””.

Asamblisti Dushan Borisavljeviq, para partisë “SRPSKA”, tha: “Si asamblist ndihem i ofenduar me faktin se Qeveria e Kosovës me këtë vendim dëshiron të tregojë humanizëm ndërsa muaj më parë i shikojmë vendimet që janë marrë me të cilat ndalohet dërgimi i barnave, produkteve ushqimore, pensioneve, përfitimeve për personat me aftësi të kufizuara dhe pagesën e përfitimeve të fëmijëve për ne dhe fëmijët tanë. Kjo është një ironi që bashkësia ndërkombëtare duhet ta parandalojë”.

Kryesuesi i Kuvendit e pyeti drejtoreshën e Urbanizmit nëse në mandatin e kaluar dhe në planin e veprimit në atë vend ishte planifikuar ndërtimi i një depoje e Ujësjellësit dhe Ekologji.

Drejtoresha e Drejtorisë Komunale për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, Aleksandra Gjekiq, u përgjigj se në Graçanicë komuna i posedon vetëm këto parcela ku mund t'i zgjerojë ndërtesat administrative dhe ku gjendet ndërtesa administrative komunale, ndërtesa e Gjykatës Themelore nga Prishtina, Shtëpia e të moshuarve, Shtëpia e të rinjve, Qendra e biznesit, Inkubatori social, varrezat e reja me kapelë dhe objekti ndihmës. Me vendim të Kuvednit të komunës nga viti 2019, Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit i janë ndarë 20 ari nga ajo parcelë për shfrytëzim afatgjatë, ndërsa është planifikuar t'i ndahen 50 ari Ndërmarrjes publike-komunale “Ekologjia” dhe komuna posedon edhe një projekt për ndërtimin e bypass-it që kalon përmes parcelës 17-8 .

Drejtori i Drejtorisë Komunale për Zhvillimin Ekonomik dhe Integrime, Nebojsa Milovanoviq, tha: “Plani Zhvillimor i Komunës së Graçanicës, i cili pritet të miratohet, parashev që 50 hektarë nga ajo parcelë të ndahen për energji të gjelbër, sepse sipas disa hulumtimeve, ajo parcelë është ideale për këtë sepse ka shumë ditë me diell. Ka pasur kompani që kanë ardhur në komunë dhe kemi biseduar me to për atë temë, por jemi në pritje të miratimit të Planit Zhvillimor Komunal që të fillojmë konkretisht me atë histori. Ne si drejtori jemi kundër ndërtimit të asaj qendre në këtë lokacion sepse do të rrezikonte planet serioze të komunës”.

Kryesuesi e hodhi në votim Konkluzionin:

Neni 1

Kuvendi i Komunës së Graçanicës e kundërshton marrjen e njëanëshme të Vendimit nr.05/218 nga Qeveria e Kosovës, të nxjerr në mbledhjen e Qeverisë më datën 28.08.2024, në pjesën që i referohet marrjes së pronësisë në parcelat, në pronësi të Komunës së Graçanicës.

Neni 2

Obligohet kryetarja e komunës që t'ia paraqesë Qeverisë së Kosovës kundërshtim ndaj Vendimit nr.05/218 të datës 28.08.2024 dhe të kërkojë ndryshimin e pjesshëm të Vendimit në paragrafin 3, me përjashtim të veçantë nga Vendimi të parcelës nr.17-8 ZK Graçanicë, në pronësi të Komunës së Graçanicës.

Neni 3

Faqe 5 - 6

Obligohet kryetarja e komunës dhe drejtoritë kompetente komunale që t'i ndërmarrin veprimet e tjera të nevojshme para organeve, organizatave dhe institucioneve tjera, për ta arritur qëllimin nga nen 2 i këtij Konkluzioni.

Neni 4

Ky Konkluzion hyn në fuqi ditën e publikimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Asamblisti Granit Gashi, para partisë “Aleanca Shqiptare”, tha se është pro ndërtimit të kësaj Qendre.

Kryesuesi e pyeti asamblistin Gashi nëse është për ndërtimin e Qendrës në një vend që nuk është pastruar nga minat dhe që është në hall me Djerrinën.

Asamblisti Granit Gashi, para partisë “Aleanca Shqiptare”, u përgjigj se këtë vendim e ka marrë Qeveria e Kosovës si dhe se ajo i ka bërë studimet e ndjeshmërisë me ekspertë, ndërsa ne nuk jemi ekspertë të tokës.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me votat e 17 asamblistëve “Pro”, dhe 1 votë “Kundër” të Granit Gashit miratoi konkluzionin nga pikë e dytë e rendit të ditës.


Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Të ndryshme.

Pasi që askush nuk e mori fjalën për të diskutuar lidhur me pikën “Të ndryshme” të rendit të ditës, kryesuesi falënderoi për bashkëpunim dhe mbledhja mbaroi në orën 12:03.

Procesmbajtësi:

Agron Karadollami



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Milan Dimitrijević